

# Newsletter

Dhjetor 2019



invest in Albania

## AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka një pozicion unik brenda rrjetit të institucioneve publike shqiptare.

AIDA, nga njëra anë ofron informacion dhe shërbime ndaj investitorëve të huaj të cilët duan të investojnë në Shqipëri mbi mundësitë e investimit, zhvillimit të biznesit apo partnerët lokal.

Nga ana tjetër, ofron mbështetje për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme shqiptare, në mënyrë që ato të bëhen gjithnjë e më konkurruese në tregun vendas e të huaj veçanërisht në zhvillimin e eksporteve si edhe në stimulimin e inovacionit.

Që nga krijimi i saj, AIDA ka marrë pjesë dhe ka organizuar forume biznesi, workshope, seminare, panaire brenda dhe jashtë Shqipërisë.



"Ne synojmë zhvillimin e një strukture dinamike të orientuar drejt ofrimit të shërbimeve profesionale One Stop Shop ndaj investorëve vendas dhe të huaj, të cilët duan të investojnë kapitalin e tyre në Shqipëri.

Gjithashtu ne do të vijojmë të mbështesim zhvillimin e biznesit shqiptar, për ta bërë atë më konkurrues në tregun vendas dhe në veçanti në tregun e huaj, nëpërmjet zhvillimit të ideve të reja në biznes si dhe nxitjes së inovacionit.

Suksesi i AIDA-s në përmbushjen e misionit të saj lidhet ngushtë me konsolidimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me agjencitë homologe, organizatat dhe institucionet lokale e qendrore.

Ne jemi mbështetja që ju duhet në vendimin tuaj për të investuar, për të zhvilluar biznesin tuaj dhe për të konkurruar në treg".

*Sokol Nano*  
*Drejtor Ekzekutiv*

## AIDA - FOKUS INFORMIMI I BIZNESEVE

AIDA, ka në fokus rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve shqiptare të vogla dhe të mesme, duke mbështetur zhvillimin e tyre si dhe të eksporteve shqiptare. Rritja e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve shqiptare i bën ato më tërheqëse për investitorët e huaj. Nëpërmjet Drejtorisë NVM dhe Projekteve[1], AIDA ofron shërbime në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare nëpërmjet asistencës teknike, ndërtimit të kapaciteteve, informacionit mbi tregjet, doganave, etj.; mbështetje për promovim, nëpërmjet panairove, misioneve të biznesit, kërkimeve të tregut dhe publikimeve të përgjithshme sektoriale, krijimit të një mjedisi të favorshëm për inovacionin si dhe asistim për bizneset e reja Start – Up.

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme janë një nga motorët kryesorë të zhvillimit të ekonomisë shqiptare. AIDA në kuadër të informimit të NVM-ve organizon Info Day, duke i ardhur në ndihmë bizneseve me informacione se si mund të bëhen pjesë e skemave dhe projekteve që AIDA menaxhon. Më poshtë do të informoheni mbi Info Day dhe takimet monitoruese në kuadër të shërbimeve të AIDA për NVM-të.

[1] Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM)

### Takime monitoruese dhe Info Day në qytetin e Korçës

Takime monitoruese janë realizuar nga stafi i AIDA, më 10 korrik 2019, pranë kompanive "Mjalti Morava" dhe "Mastor sh.p.k" në qytetin e Korçës, për të parë ecurinë dhe vënien në zbatim të fondeve të përfituara nga AIDA.

Stafi mbajti dhe një seminar informues (Info Day) për bizneset e rrethit Korçë, për grantet dhe shërbimet e tjera që AIDA ofron në mbështetje të NVM-ve shqiptare. AIDA në rolin e koordinatorit të projektit Enterprise Europe Network (EEN), informoi bizneset pjesëmarrëse edhe mbi projektin “Rrjeti European të Ndërmarrjeve” dhe se si mund të bëhen pjesë e tij.





### Takime monitoruese dhe derë më derë në qytetin e Lushnjës dhe Beratit

Stafi i AIDA për monitorimin dhe ardhjen në ndihmë të biznesit ka zhvilluar takime gjatë muajit shtator 2019 në kompanitë e qytetit të Lushnjës dhe Beratit, të cilat janë përfituese të fondit të Konkurrueshmërisë dhe të Artizanatit. Takimet janë zhvilluar në kompanitë: "Xhamo sh.p.k", "Kantina Cobo", Rudina Isufi, person fizik dhe Elona Jorgji, person fizik.



Në vijim, stafi i AIDA-s zhvilloi takime derë më derë për promovimin e fondeve të menaxhuara nga AIDA dhe të Rrjetit European të Ndërmarjeve (EEN). Kompanitë që u informuan për fondet dhe projektin ishin: "Mediterranea", "Gal Limited", "Kajo Dress Center" dhe Teuta Kurti person fizik.

### Takime monitoruese dhe derë më derë në qytetin e Tiranës dhe Elbasanit

Stafi i Drejtorisë NVM dhe Projekteve i AIDA-s ka ndalur për monitorim dhe në kompanitë "Shkalla sh.p.k", "Kuld sh.p.k", "LF Infisi sh.p.k", "Berxhani sh.p.k", "Muça Sh.p.k", "Malna Tex" dhe "Eria Textiles sh.p.k" dhe "Artizane Antoneta Tafa", të qytetit të Tiranës dhe Elbasanit. AIDA në ndjekjen e menaxhimit të fondeve të disbursuara gjatë muajit korrik 2019, është angazhuar në monitorimin e progresit të realizuar nga kompanitë të cilat kanë përfituar nga fondet dhe impaktin e skemave financiare të menaxhuara prej tyre.

Prodhimet e kompanive tona gjenden sot në shumë tregje europiane. Rritja e eksporteve shqiptare të produkteve tona përbën një potencial shumë të madh në zhvillimin ekonomik dhe është një prezantim shumë i mirë i Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare.





## AIDA, me aktivitet informues edhe në qytetin e Durrësit

U mbajt në qytetin e Durrësit gjatë muajit shtator 2019, një Info Day nga stafi i AIDA. Kjo ditë informimi pati si qëllim promovimin e shërbimeve të AIDA për NVM-të shqiptare, grantet, aksesin në financë dhe projektin e EEN Albania.



Pas aktivitetit, stafi zhvilloi takimin me Kryetarin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Durrës, me qëllim konsolidimin e kontakteve në ndihmë të bizneseve në Durrës.

## AIDA, me aktivitet informues në qytetet Gjirokastrë dhe Tepelenë

Gjatë muajit tetor, stafi i AIDA-s, vizitoi në qytetin e Tepelenës dhe Gjirokastrës bizneset përfituese të fondeve të menaxhuara prej saj dhe informoi kompanitë mbi shërbimet që ofron në ndihmë të bizneseve shqiptare. Kompanitë u informuan edhe mbi Rrjetin European të Ndërmarrjeve (EEN), mënyrën e regjistrimit dhe lidhjes së kontratave në vijim.

Për rritjen e bashkëpunimit institucional, takimet u zhvilluan në bashkëpunim me Z. Maksim Hoxha, Kryetar i Dhomës së Tregtisë Gjirokastrë. Këto vizita u zhvilluan në kompanitë: "J&Blue Fashion" - Prodhim dhe eksport i veshjeve textile "Made in Albania", "Lubjana Baoja Artizane", "Diamant Bags" - Prodhim dhe eksport të çantave prej letre, "Argjiro Group" - Paketim, printim dixhital dhe promocion, "Kalimera" - Produkte brumi dhe ëmbëlsira, "Green Enterprise" - Prodhim i vasketave për produkte ushqimore, "Cotex sh.p.k" - Fason, prodhim dhe eksport të veshjeve, "Marika Tex" - Prodhim i rrobave të punës për forcat speciale, "Handmade by Olga" - Prodhim i produkteve të ndryshme artizanale.



## PRIORITETI YNË - NDËRTIMI I MARDHËNIEVE TË MIRA SHUMËPALËSHE

AIDA, në përmbushje të misionit të saj ndërmerr hapa konkrete nëpërmjet organizimit të aktiviteteve si: forume biznesi, konferenca, ekspozita, panaire, si dhe veprimtari të tjera promovionale, në bashkëpunim me institucione të tjera. Agjencia bashkëpunon vazhdimisht me institucionet publike, financiare, organizatat e biznesit shqiptare dhe të huaja, për të krijuar një sistem shkëmbimi të dhënash, i cili lehtëson lidhjet tregtare dhe krijon mundësitë për shfrytëzimin e hapësirave të reja për shoqëritë e produkteve shqiptare për eksport. Me qëllim pjesëmarrjen e ndërmarrjeve shqiptare që prodhojnë mallra dhe ofrojnë shërbime të destinuara për eksport dhe tërheqjes së investitorëve të huaj, AIDA ka qenë partnere dhe pjesëmarrëse në disa forume biznesi dhe takime B2B.

### Mundësi partneriteti mes bizneseve në eventin “Misioni Ekonomik Belg në Shqipëri”

Ambasada Belge në Shqipëri dhe zyra “Flanders and Investment Trade” (FIT), me mbështetjen e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), zhvilluan në muajin qershor “Misionin Ekonomik Belg në Shqipëri”. Në këtë mision të rëndësishëm bashkëpunimi, mbajtën fjalën e tyre prezantuese, pjesëmarrësit nga delegacioni belg dhe shqiptar. Z. Genc Çeli, përfaqësues i AIDA, bëri një prezantim të misionit dhe shërbimeve të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, sektorëve strategjikë dhe të dhënave mbi investimet e huaja në Shqipëri, lehtësirat që ofron ligji shqiptar Nr.10 316, Datë 16.9.2010 “Për Investimet e Huaja” dhe avantazheve përse investitorët duhet të zgjedhin Shqipërinë për të investuar.

Ky takim biznesi vijoi me sesionin e prezantimit të sipërmarrjeve nga të dyja vendet. Më pas misioni vazhdoi me takimet B2B, ku u krijuar mundësia për vendosjen e kontakteve të reja bashkëpunuese ndërmjet bizneseve pjesëmarrëse. Nga ky takim palët krijuan kontakte të rëndësishme.





## Në Zvicër, kompanitë vendase mbajnë një takim informues mbi mundësinë e të bërit biznes në Shqipëri

Në muajin maj 2019, në Zyrih të Zvicrës u organizua takimi “Explore Albania – Agribusiness”. Përfaqësues të Ministrisë Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), u prezantuan bizneseve zvicerane dhe pjesëmarrësve të tjerë zhvillimet e fundit ekonomike të Shqipërisë, mundësitë që ofron Shqipëria për investime dhe potencialin për eksport në sektorin bujqësor.

Kompanitë zvicerane që veprojnë në Shqipëri: Kunzli dhe SICPA ndanë përvojën e tyre mbi të bërit biznes në Shqipëri. Po ashtu edhe bizneset shqiptare të pranishme në event, prezantuan për kompanitë zvicerane mundësitë konkrete për investim dhe eksport.

Me anë të këtij takimi u arrit njohja dhe prezantimi i potencialeve për eksport të vendit tonë, si edhe krijimi i kontakteve me synim thithjen e investimeve në Shqipëri.

## AIDA, pjesë e Forumit të Biznesit në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Poloni

Samiti i Ballkanit Perëndimor në Poznań mirëpriti më 4 korrik 2019 delegacionet qeveritare, përfaqësues të organizatave civile dhe sipërmarrës nga 16 vende si: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia Veriore, Serbia, Austria, Bullgaria, Kroacia, Franca, Greqia, Gjermania, Polonia, Sllovenia, Italia dhe Britania e Madhe. Qëllimi i Samitit ishte integrimi i Ballkanit Perëndimor me vendet e Bashkimit Evropian dhe rritja e bashkëpunimit në politikë, shoqëri civile dhe biznes. Gjatë këtij samiti u mbajt dhe Forumi i Biznesit, ku AIDA ishte pjesëmarrëse me standin e saj. Gjatë Forumit të Biznesit përfaqësues të AIDA-s zhvilluan takime B2B me biznese polake dhe bizneseve të vendeve të tjera pjesëmarrëse. Kjo ngjarje e rëndësishme do të kontribuojë në forcimin e marrëdhënieve të ndërsjellta ekonomike mes rajoneve.





### Takim informues i AIDA me përfaqësues të Konsorciumit për Zhvillimin Industrial Roma - Latina

Takimi ndërmjet AIDA-s dhe përfaqësuesve të Konsorciumit për Zhvillimin Industrial të Romës dhe Latinës, në korrik 2019, pranë mjediseve të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, pati si qëllim njohjen e ndërsjelltë dhe shkëmbimin e informacioneve mbi aktivitetin e të dy institucioneve. Tema kryesore e takimit ishte mbi kriteret e aplikimit për të fituar statusin e investitorit strategjik. Në takim u diskutua dhe roli i AIDA-s në këtë proces, nga hapi i propozimit të projektit e deri në rezultatin final.



### Zhvillohet në Tiranë Forumi i Biznesit “Shqipëri - Kroaci”

Zhvillohet në muajin korrik 2019, Forumi i Biznesit “Shqipëri – Kroaci”, si një nismë e rëndësishme bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve. Pjesë aktive e Forumit të Biznesit “Shqipëri – Kroaci” ishin edhe përfaqësuesit e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), të cilët u prezantuan kompanive pjesëmarrëse misionin dhe rolin në ndihmë të investitorëve të huaj. Gjatë forumit stafi i AIDA-s takoi çdo kompani të huaj dhe shqiptare që ishte pjesë e forumit, duke shprehur gatishmërinë në ndihmë të bizneseve me shërbimet që AIDA ofron.



### Takimi mes AIDA dhe ekspertëve të Bankës Botërore

Në kuadër të bashkëpunimit institucional, por edhe të identifikimit të çështjeve me interes për të dyja palët, u zhvillua në muajin tetor një takim i përfaqësuesve të AIDA-s me ekspertë të Bankës Botërore Z. Christoph Ungerer dhe Znj. Hilda Shijaku. Në këtë takim ekspertët e Bankës Botërore u njohën nga përfaqësues të AIDA me rolin, misionin dhe shërbimet që AIDA ofron në mbështetje të NMV-ve shqiptare dhe promovimin e eksporteve. Takimi u përmbyll me vendosjen e pikave të bashkëpunimit në drejtim të promovimit të eksporteve. Banka Botërore gatishmëri në ofrimin e asistencës teknike për zhvillimin dhe promovimin e eksporteve Shqiptare.



## AIDA MERR PJESË AKTIVE NË PANAIRET KOMBËTARE E NDËRKOMBËTARE

Agjencia, në funksion të veprimtarisë së saj, ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si dhe duke ndërmjetësuar e bashkëpunuar me organet shtetërore. Agjencia, me qëllim fuqizimin dhe rritjen e aftësive konkurruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, siguron të dhëna të nevojshme për bizneset dhe mundëson përhapjen e tyre, nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti shkëmbimi të informacioneve. AIDA ndihmon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në përfitimin e financimeve publike, kombëtare dhe ndërkombëtare, si nëpërmjet fondeve të menaxhuara nga AIDA, por edhe nëpërmjet informimit dhe sigurimit të kontakteve për projekte partnere dhe jo vetëm.

Nëpërmjet pjesëmarrjes në panire kombëtare dhe ndërkombëtare, AIDA promovon produktet dhe shërbimet shqiptare në tregjet ndërkombëtare, për të reklamuar dhe për të lehtësuar eksportin e produkteve "Made in Albania".

### Panairi Ndërkombëtar i Turizmit në Berlin, AIDA prezanton mundësitë për investime në Shqipëri

U mbajt në muajin mars 2019, Panairi Ndërkombëtar i Turizmit në Berlin "I.T.B Berlin Fair", ndër më të rëndësishmit dhe më të mëdhenjtë në botë, i cili krijoi mundësinë për njohjen dhe kontaktimin e drejtpërdrejtë të qindra operatorëve turistikë. Shqipëria ishte pjesëmarrëse me stendën e saj, të vizituar me interes të lartë nga Tour Operatorët më të njohur ndërkombëtarë, duke konfirmuar edhe një herë rritjen e turizmit dhe potencialet e larta të vendit tonë për konsolidimin e Shqipërisë si destinacion turistik.

I ftuar në këtë panair ishte dhe Drejtori Ekzekutiv i AIDA Z. Sokol Nano, i cili prezantoi për investitorët dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë të sektorit të turizmit, pronat shtetërore të përshtatshme për zhvillimin e resorteve turistike, si dhe procedurat e aplikimit për marrjen e statusit të investitorit strategjik në turizëm dhe incentivat përkatëse të këtij sektori.



Shqipëria ngjitet me 12 pozicione në renditjen e World Economic Forum për turizmin, 2019. Raporti "The Travel & Tourism Competitiveness Report 2019", publikuar nga World Economic Forum, tregon se Shqipëria është ngjitur në renditje me 12 vende, në krahasim me 2 vite më parë. Ky rezultat tregon që turizmi në Shqipëri është bërë më konkurrues gjatë 2 viteve të fundit dhe po vazhdon të zhvillohet me hapa të suksesshëm.



## Panairi "Munich Fabric Start", Gjermani

AIDA, në kuadër të bashkëpunimit me SIPPO Albania për ndërkombëtarizimin e kompanive shqiptare, mori pjesë në panairin e veshjeve dhe tekstilit "Munich Fabric Start", që u zhvillua në muajin shtator 2019 në Mynih. AIDA, së bashku me përfaqësues të kompanive morën pjesë më një stendë për prezantimin e sektorit të veshjeve dhe tekstileve në Shqipëri dhe potencialin që mbart ky sektor. Përfaqësues të Agjencisë zhvilluan takime me organizata nga vende të ndryshme si Rrjeti Gjerman i Modës dhe design VDMD, organizatorët e panairit Pure London, Agjencinë e Investimeve të Vietnamit, Dhomat e Tregtisë së Rajonit të Ballkanit, të cilët treguan interes për bashkëpunime të mëtejshme me kompanitë shqiptare në këtë sektor.

## Panairi i Tekstilit dhe Lëkurës 2019, në Expocity, Tiranë

Panairi i Tekstilit dhe Lëkurës, i zhvilluar në nëntor 2019, përfaqësoi një pikë takimi për prodhuesit më të mëdhenj e më të rëndësishëm shqiptarë dhe të huaj në këtë fushë.

AIDA ishte pjesëmarrëse në këtë Panair me një stendë, si pikë e rëndësishme informacioni për bizneset vendase dhe të huaja, mbi sektorin e tekstileve në Shqipëri dhe mundësitë për zhvillimin e sektori. Pjesëmarrës në këtë panair ishin përfaqësues të lartë të shtetit, të cilët mbajtën fjalën e tyre në hapjen e tij dhe tryezën e rrumbullakët që u zhvillua në kuadër të diskutimit të problemeve me të cilat haset biznesi dhe mënyrat se si mund të adresohen nëpërmjet institucioneve përkatëse. Përfaqësuesja nga AIDA, Znj. Mileva Meksi përmendi të gjitha mekanizmat mbështetës në ndihmë të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, por gjithashtu edhe për bizneset e mëdha.

Kompanitë e ekspozuara promovuan produktet e tyre gjatë dy ditëve të panairit dhe patën mundësinë të krijojnë ura bashkëpunimi ndërmjet kompanive pjesëmarrëse.





## AIDA në panairin A+A Dusseldorf, Gjermani

Në nëntor 2019, u mbajt në Dusseldorf, Gjermani Panairi A+A, i veshjeve të punës dhe produkteve të tjera të sigurisë në punë. Ky panair cilësohet si një nga më të rëndësishmit në Europë për sektorin e tekstileve dhe kompanive që janë pjesë e procesit të veshjeve të punës.

AIDA në bashkëpunim me SIPPO-n, mundësuan që kompanitë shqiptare të përfaqësoheshin me një stendë të përbashkët, ku mund të prezantonin veshjet e tyre të punës, por edhe të zhvillonin takime me kompani të tjera europiane, me qëllim lidhjen e kontratave të reja të punës.

Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, në takim me kompanitë shqiptare pjesëmarrëse në Panair, përkrahu idenë e tyre për një organizim edhe më gjithëpërfshirës në edicionin e ardhshëm të Panairit dhe i siguroi pjesëmarrësit për mbështetjen e plotë të AIDA-s, në çdo hallkë ku ata do të kenë nevojë për asistencë.

Përgjatë Panairit A+A, firmat shqiptare që u bashkuan në stendën e AIDA-s kishin një program të plotë me takime, vizita studimore, pritje në stendë për të interesuarit direkt për shërbimet dhe produktet që ato ofrojnë. AIDA dhe SIPPO shërbyen si pika lidhëse ndërmjet kompanive, vizitorëve dhe firmave të huaja potenciale për investime në sektorin e tekstileve dhe rrobave të punës.

Pas interesimit të shtuar të kompanive për pjesëmarrje në panair, do të shihet mundësia që në sesionin e radhës të kemi edhe një organizim më të plotë dhe gjithëpërfshirës, e gjitha kjo në mbështetje të biznesit vendas.





## Panairi Ndërkombëtar i Tiranës, në datat 23 - 26 nëntor 2019

Në datat 23 - 26 nëntor, u zhvillua në Tiranë, Panairi Ndërkombëtar i Tiranës, i organizuar nga Klik Ekspo Group. AIDA kishte një rol të rëndësishëm në këtë panair si bashkëorganizator i kalendarit të eventeve për takimet B2B ndërmjet bizneseve shqiptare dhe kompanive të huaja të ardhura nga Serbia, Hungaria, Italia, Turqia etj.

Në këtë edicion të 26-të të panairit, AIDA është pjesëmarrëse si institucion që promovon Shqipërinë si një destinacion për investime, duke lehtësuar dhe mbështetur investimet direkte në Shqipëri, por edhe sipërmarrjet shqiptare. Prania e AIDA-s me një stendë mundëson gjithashtu edhe zhvillimin e takimeve dhe konsultave me palët e interesuara, me fokus investitorët e huaj dhe sipërmarrjet shqiptare.



## Produktet “Made in Albania” promovohen në Panairin Ndërkombëtar Artigiano in Fiera

Në Panairin Ndërkombëtar “Artigiano in Fiera”, i zhvilluar në Milano, në datat 30 nëntor – 8 dhjetor 2019, Shqipëria u përfaqësua për herë të parë. AIDA ishte pjesëmarrëse me një stendë, ku u promovuan produktet artizanale “Made in Albania” në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Zejeve dhe Fondacionin Tradita Popullore.

Stenda në panair përfaqësohej me produkte nga të gjitha trevat e Shqipërisë, si kostume popullore, qilima, qeleshe, kapele të qëndisura me gajtan, si edhe qëndisma me motive të ndryshme. Vizitorët e shumtë nga e gjithë bota vizituan stendën dhe treguan interes të veçantë për produktet tona artizanale shqiptare.



## Samiti i II i Diasporës Shqiptare, Mars 2019

Samiti i II-të i Diasporës, mbledhi qindra përfaqësues të Diasporës Shqiptare në muajin Mars 2019. Punimet e Samitit vijuan ditën e dytë në formën e panairit, ku AIDA kishte standin e saj të informimit të pjesëmarrësve. Pas ceremonisë së hapjes, Samiti vazhdoi me mbajtjen e katër paneleve paralele me tema të ndryshme diskutimi.

Në panelin “Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik”, të organizuar gjatë Samitit të dytë të Diasporës, ka marrë pjesë Ministri e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj dhe Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano. Në fjalën e tij, Drejtori i AIDA-s, Z. Sokol Nano ka vënë në dukje rolin e kontributit që duhet të ketë diaspora Shqiptare në zhvillimin e vendit. Kontributi i zhvillimit të diasporës përmes transferimit të përvojës dhe eksperiencës së suksesshme, do të ketë një ndikim pozitiv në progresin e vendit.

Z. Nano prezantoi dhe agjencinë, duke theksuar rolin e rëndësishëm në informimin e biznesit, thithjen e investimeve të huaja, ndjekjen e investimit në të gjitha hapat e krijimit të kompanisë, por dhe pas saj. Paneli u mbyll me ndarje idesh për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit nëpërmjet eksperiencës, njohurive dhe dijeve të Diasporës.



## AIDA KUJDESET PËR BIZNESIN NËPËRMJET SHËRBIMEVE AFTERCARE

Shërbimi Aftercare, është sektori i dedikuar pranë AIDA-s për identifikimin e problematikave të investitorëve dhe adresimin e tyre në zgjidhjen përfundimtare, në bashkëpunim me ministritë e linjës. Në kuadër të përkujdesjes ndaj investitorit, AIDA ka zhvilluar disa takime, të cilat kanë ndikuar në përmirësimin dhe vazhdimësinë e punës të kompanive të asistuar.

Fokusi kryesor i AIDA-s është tërheqja e investimeve të huaja në vendin tonë dhe më pas përkujdesja e mëtijshme, duke synuar përmbushjen në mënyrë të suksesshme të kërkesave të investitorëve të huaj edhe gjatë ndjekjes së projekteve të investimit.

Që prej gati tre vitesh, AIDA ka patur një rol proaktiv ndaj përfaqes së investitorëve të huaj të pranishëm në Shqipëri. Në kuadër të një Plani Veprimi të përpiluar për vitin 2018 - 2019, AIDA është e përfshirë në krijimin e një rrjeti efektiv komunikimi në bashkëpunim me aktorë të rëndësishëm në nivel lokal dhe qendror, me qëllim mbështetjen e ri-investimeve në vend.

Gjatë periudhës Janar - Qershor 2019 janë zhvilluar nga sektori Aftercare i AIDA 41 vizita në bashkëpunim me bashkitë e qyteteve: Tiranë, Elbasan, Durrës, Berat, Lezhë, Vlorë, Shkodër dhe Fier.

### AIDA kujdeset për biznesin AIDA Aftercare

**Puna e AIDA-s** kundrejt biznesit të huaj dhe vendas lidhet direkt me lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve direkte në Shqipëri, rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve), nxitjes dhe mbështetjes së eksporteve të mallrave dhe shërbimeve.

**Sektori i Aftercare** në AIDA është duke targetuar kompani të reja në sektorë strategjikë dhe me shpërndarje sa më të plotë në gjithë vendin tek të cilat do të zhvillohen vizita të specializuara për të mundësuar asistimin sa më të plotë të këtyre bizneseve.

### 41 VIZITA NË KOMPANI

në gjashtë mujorin e parë, në bashkëpunim me bashkitë e qyteteve:



 **+4000**  
TË PUNËSUAR

 **+1 MILIARDË €**  
KAPITAL I INVESTUAR

 **+25 MILIONË €**  
KAPITAL I RI-INVESTUAR  
NGA 9 KOMPANI

 **26 KOMPANI**  
TË ASISTUARA NGA AIDA

## AIDA me shërbimin e përkujdesjes për kompanitë e qytetit të Shkodrës, në kuadër të programit Aftercare

Sektori i përkujdesjes ndaj Investitorit/Aftercare shoqëruar nga stafi i Bashkisë Shkodër, gjatë muajit Mars 2019, në kuadër të Programit “Investment promotion & Aftercare” ka realizuar vizita në disa kompani në qytetin e Shkodrës, për t’i ardhur në ndihmë kompanive. Kompanitë në të cilat janë realizuar takime nga stafi i After-care janë: "Famiko Shoes", "Moda Teli", "B&G Service Group", "Unika Industries", "Dafinor", me të cilat u diskutuan problemet që kompanitë hasnin kryesisht në gjetjen dhe kualifikimin e forcës punëtore, vlerësimin e nevojave në shërbimet e ofruara ndaj biznesit dhe përcaktimin e potencialeve për riinvestim. Stafi i AIDA-s informoi kompanitë mbi shërbimet që ofrohen nga agjencia dhe shprehu gatishmërinë për adresimin e problemeve të shfaqura.



## AIDA së bashku me qeverisjen vendore zhvillojnë takime me bizneset në Elbasan

AIDA, si një partner i rëndësishëm dhe i besueshëm për kompanitë që kanë investuar tashmë në vendin tonë, së bashku me qeverisjen vendore kanë zhvilluar vizitat e radhës në qytetin e Elbasanit. Stafi i Aftercare pranë AIDA-s dhe Bashkia Elbasan ka pëzgjedhur të vizitojnë gjatë muajit Prill 2019, kompanitë "Delmon Group" dhe "IT&AL", "Bio Funghi", "Dieta sh.p.k" dhe "Victus FED". Vizitat kanë qenë angazhimi i AIDA-s për t’u njohur me objektivat dhe realizimin e planit të biznesit të kompanive, si dhe për t’i asistuar ato në çdo problematikë të hasur.

Stafi i AIDA-s gjatë takimeve ka informuar disa kompani, mbi përfitimet dhe shërbimet e agjencisë dedikuar sipërmarrësve shqiptarë, siç është dhënia e granteve të Shtetit Shqiptar apo identifikimi i tregjeve, ose partnerëve të rinj për eksport, nevojave për çertifikim produkti, etj.



## Sektori i përkujdesjes ndaj investitorit, vizitë bizneseve në Vlorë

Sinergia e koordinimit dhe bashkëpunimit me qeverisjen vendore në funksion të ndihmës ndaj investitorëve të huaj dhe vendas, si edhe dëgjimi nga afër i problematikave që has biznesi duke ndërmjetësuar në adresimin e tyre, ka qënë qëllimi i vizitave të realizuara në qytetin e Vlorës gjatë muajit Prill. Stafi i Aftercare pranë AIDA-s, shoqëruar nga përfaqësues të Bashkisë Vlorë ishin të pranishëm, gjatë vizitave për të dëgjuar nevojat dhe plotësuar kërkesat në ndihmë të kompanive. Takimet janë zhvilluar në kompanitë “Helios”, “Simak Shoes”, dhe “Tomaificio Maro” “Alb Sale”, “MetalPro 2015”. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve nëpërmjet përfshirjes dhe ndërtimit të një rrjeti bashkëpunues me Bashkinë e qytetit, synon të realizojë një koordinim më të mirë me qëllimin final adresimin e shpejtë dhe efikas të problematikave me të cilat përballen investitorët vendas dhe të huaj.



### Aftercare, vizitë kompanive në qarkun Durrës

Sektori i përkujdesjes ndaj investitorit/Aftercare, së bashku me punonjës të Bashkisë e Durrësit kanë vizituar në muajin prill 2019, kompanitë operuese në sektorin automotiv dhe elektronik.



Vizitat u zhvilluan përkatësisht në kompanitë "Rework sh.p.k", "Giobert" dhe "Climb Cat". Vizitat në këto kompani kishin synim koordinimin më të mirë me qëllimin adresimin e shpejtë dhe efikas të problematikave me të cilat kompanitë përballen.



## AIDA vizitë edhe kopmanive në qytetin e Beratit

Në funksion të rritjes së koordinimit dhe bashkëpunimit me njësitë e qeverisjes vendore, me qëllim ndihmën ndaj investitorëve të huaj dhe vendas, sektori Aftercare pranë AIDA ka zhvilluar takime me kompanitë që zhvillojnë biznesin e tyre në qytetin e Beratit.

Së bashku me përfaqësues të Bashkisë Berat, Aftercare është ndalur pranë tre kompanive: "Center Shqiptare sh.p.k", "Caterina Firenze", "Intex dhe Vakëfi", për t'u njohur më nga afër me aktivitetin dhe problematikat e tyre.



## Vizita për përkujdesjen ndaj investimit edhe për kompanitë e qytetit të Lezhës

Në vijim të takimeve në ndihmë të investitorit të huaj dhe vendas, programi Aftercare në bashkëpunim me qeverisjen vendore, ka zhvilluar vizita me kompani të përzgjedhura në qytetin e Lezhës, përkatësisht "Amarilto" dhe kantina e verës "Kallmet".



Gjatë vizitave AIDA dhe Bashkia u njoh me aktivitetin e kompanisë Amarilto në linjën e konservimit të frutave dhe perimeve, si dhe synimet për të realizuar linjën "Made in Albania" duke investuar në cilësinë e produkteve dhe makinerive të reja.

## AIDA NXIT ZHVILLIMIN E INVESTIMEVE TË HUAJA NË SHQIPËRI

Investimet e huaja janë fokusi kryesor i AIDA-s dhe si e tillë ka përkushtimin maksimal të agjencisë në tërheqjen e investimeve në Shqipëri. Në funksion të këtij misioni të rëndësishëm, AIDA identifikon dhe promovon mundësitë e investimeve në vendin tonë, si dhe zhvillon veprimtari në funksion të përmirësimit të imazhit të Shqipërisë, në nivel ndërkombëtar.

Në Shqipëri gjenden tashmë filialet e disa prej kompanive më të rëndësishme, të cilat operojnë në sektorin telekomunikacionit dhe IT, veshjeve dhe automotivës kryesisht. AIDA i ka mbështetur kompanitë që në hapat e parë të themelimit të investimit në vendin tonë dhe vazhdon t'i vijë në ndihmë në bashkëpunim me institucionet e tjera të linjës.

Disa nga investimet e huaja të suksesshme në vendin tonë janë: "Fusion BPO", "Yura Corporation", "Forschner", "SV Mega", "Innovaway", "COTEX Textile", "Giobert", "Delmon", "PSZ Albania", etj.

## 10 REASONS TO INVEST IN ALBANIA

- 1 POZICIONI GJEOGRAFIK
- 2 QASJE NË TREG TË LIRË
- 3 MJEDIS MIQËSOR PËR BIZNESIN
- 4 MODELI ONE-STOP SHOP
- 5 MUNDËSI INVESTIMI TË LARMISHME
- 6 MBËSHTETJE LIGJORE PËR INVESTIMET E HUAJA
- 7 SISTEM TATIMOR I FAVORSHËM
- 8 FUQI PUNËTORE KONKURRUESE
- 9 INFRASTRUKTURË NË ZHVILLIM
- 10 DESTINACION TURISTIK GLOBAL



## Fusion BPO investon në Shqipëri

Kompania Fusion BPO, pas një asistence të gjatë nga stafi i AIDA-s, ka inaguruar në Janar 2019, çeljen e aktivitetit të tyre në vendin tonë, duke finalizuar kështu filialin e saj të parë në Ballkan. Fusion BPO, e cila operon në sektorin e teknologjisë, informacionit dhe komunikacionit, është prezente me 16 filiale në 9 shtete të ndryshme të botës, përfshirë Amerikën dhe Kanadanë.

Në muajin e saj të parë kjo kompani numëronte 25 të punësuar dhe synon të punosojë 300 operatorë deri në fund të vitit 2019, duke ofruar shërbime jo vetëm për tregjet europiane, por dhe më gjërë. Gjatë takimit të zhvilluar me stafin e AIDA-s, janë diskutuar çështje konkrete bashkëpunimi dhe nevoja të menjëhershme që sektori Aftercare i ka ndjekur me prioritet.



Investimeve e Huaja Direkte në Shqipëri, për vitin 2019 u rritën me 10% nga viti i kaluar për 6-mujorin e parë të 2019 dhe me një fluks prej 535 milionë Euro. Shqipëria duket se po tërheq gjithmonë e më shumë vëmendjen e sipërmarrësve të huaj, kjo dhe për faktin e mbështetjes dhe bashkërendimit të punës së AIDA-s dhe institucioneve të tjera.

## Investim i ri në Qarkun e Fierit, kompania koreano-jugore "Yura Corporation"



Në muajin korrik, në qytetin e Fierit, kompania koreano-jugore "Yura Corporation" nisi ndërtimin e stabilimentit për prodhimin e pjesëve të automobilave, me një investim prej 13 milionë Euro.

Pjesë e ceremonisë së inagurimit ishte Kryeministri i Shqipërisë, Z. Edi Rama, Drejtori i AIDA-s, Z. Sokol Nano, Ministria e Financave, Znj. Anila Denaj, Z. Lucas NAM, Ceo i Kompanisë Yura për Shqipërinë, Kryetari i Bashkisë Fier, Z. Armando Subashi, deputetë dhe autoritete të tjerë shtetërore lokale, të cilët mbajtën fjalën e tyre të falenderimit dhe prezantimit të klimës së investimeve në vend. Yura Corporation do të jetë një investim madhor, me 600 vende të reja pune në fazën e parë të prodhimit, në një fazë të dytë afro 1100 të punësuar dhe duke shpresuar për një fazë të tretë, siç e parasheh kompania, për të arritur në 4000 punonjës në rang vendi, këtu në Shqipëri.

Kompania është aktualisht në fazën e ndërtimit të fabrikës, e cila parashikohet të përfundojë brenda vitit 2019 dhe prodhimi pritet të fillojë në Janar 2020, duke arritur një cikël të plotë prodhimi në muajin Prill 2020.

Një rol të rëndësishëm në këtë investim ka edhe AIDA, për shërbimet efikase të ofruara ndaj investitorëve, siç e theksoi dhe në fjalën e tij Kryeministri i Shqipërisë, Z. Edi Rama.

Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano vuri theksin te fakti se "Yura Corporation" është kompani serioze e nivelit ndërkombëtar. Për Z. Nano. është i rëndësishëm përsheptimi i procedurave dhe afatet për investimet strategjike, ku shprehu edhe vizionin e tij për AIDA-n, si është një etnitet shtetëror që funksionon me shpejtësinë dhe efikasitetin e sipërmarrjeve private.



Sipas të dhënave statistikore të Bankës së Shqipërisë, vendi ynë arriti nivelin më të lartë historik të investimeve të huaja. Investimet e Huaja Direkte në Shqipëri u rritën me 7.3% për 9 mujorin e vitit 2019, duke arritur shifrën e 810 mln Euro, ç'ka konfirmon projeksionet e qeverisë, që viti 2019 të tejkalojë totalin e 1 Miliard Euro. Gjithashtu, vetëm për tremujorin e tretë të 2019, IHD regjistruan vlerën +272.2 mln Euro, ose +1.3%, krahasuar me +268.6 mln Euro në tremujorin e tretë të 2018.

## Drejtori Ekzekutiv i AIDA, Z. Sokol Nano mirëpret në një takim Drejtorin e Ri për Europën të kompanisë Yura Corporation

Drejtori i Ri për Europën i kompanisë Yura Corporation, Z. Choi, u mirëprit në një takim nga Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, në kuadër të mbarëvajtjes së marrëdhënieve mes AIDA-s dhe përfaqësuesve të investimit strategjik të Yura Corporation.

Gjatë takimit u diskutua mbi ecurinë e projektit të kompanisë Yura Corporation, për problematikat e hasura, të cilat deri tani kanë qënë minimale, zgjidhjen e ndërmarrë me asistencën e AIDA, duke theksuar mbështetjen e vazhdueshme të AIDA gjatë gjithë fazës së zbatimit të projektit.



## Kompania Forscher inaguron stabilimentin e 3-të në Durrës

Kompania Gjermane Forscher inaguroi në muajin Janar 2019, stabilimentin e 3-të të prodhimit në vendin tonë. Kjo kompani operon në sektorin e industrisë automotiv dhe llogarit rreth 700 të punësuar në Tiranë dhe Durrës.



AIDA ka ndihmuar kompaninë që në hapat e parë të themelimit të saj nëpërmjet shërbimeve të ndryshme, si përzgjedhja e pronave, këshilla mbi kuadrin ligjor dhe financiar, si dhe shërbimin e kujdesit pas dhe adresimin e të gjitha problemeve në nivelet më të larta të vendimmarrësve. Në vendin tonë shihet interesi gjithnjë e më i lartë nga kompanitë e huaja për sektorin automotiv, nisur kjo nga kostot konkurruese të fuqisë punëtore, logjistika e përshtatshme, fuqia punëtore e kualifikuar dhe prezenca e shkollave profesionale.

## Kompania Rework Sh.p.k, një shembull sukseesi prej tre vitesh në tregun shqiptar

Kompania Rework Sh.p.k. ka zgjedhur Shqipërinë si vendin më të mirë për të investuar. Kompania është asistuar nga AIDA që në hapat e para të themelimit të biznesit, duke ofruar një studim të mirëfilltë të tregut, regjistrimin e tij dhe asistencën në hapat e mëtejshëm të zhvillimit. Prej gati tre vitesh tashmë, kompania ka treguar një rritje dhe zhvillim në cilësinë e produkteve që ajo ofron në fushën e prodhimit, instalimit, mbledhjes, çmontimit (shpërbërjen) dhe rigjenerimit të produkteve elektrike dhe elektronike, ku kompania parashikon një ri-investim, duke shtuar dhe një tjetër linjë prodhimi.



## AIDA viziton investimin e huaj me kapital 100% francez "Delmon Group Albania"

Në kuadër të fushatës për këshillimin, asistencën dhe lehtësimin e veprimtarisë së investitorëve të huaj në vend, AIDA vijon vizitat në kompanitë e huaja në Shqipëri. Këto vizita vendosin AIDA-n proaktive në zgjidhjen e ndjekjen e shqetësimeve, me qëllim final ri-investimin dhe zgjerimin e kompanisë. Me këtë qëllim Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, z. Sokol Nano, vizitoi kompaninë "Delmon", e cila operon në tregun tonë që nga viti 2017 në sektorin automativ. Delmon Group Albania është një kompani me kapital 100% francez në sektorin automobil e specializuar në prodhimin dhe përpunimin e metal-gomës për funksione antivibrimi dhe izolimi për industrinë automobilistike, hapësirën ajrore dhe hekurudhat. Gjatë vizites në kabanonin e Delmon, z. Nano dhe z. Ertjan Çabiri, drejtori i përgjithshëm i kompanisë, diskutuan për arritje dhe problematika konkrete e mbi të gjitha për adresimin e tyre. Një nga pikat më të ndjeshme e paraqitur nga kompania ishte specializimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore, pikë për të cilën AIDA mori zotimin për ta adresuar në institucionet përkatëse.



## Innovaway, investim i suksesshëm i asistuar nga AIDA

Innovaway është një prej shumë kompanive italiane që ka investuar në Shqipëri. Kompania është themeluar në vitin 2015 dhe operon në fushën e ICT-së, duke ofruar zgjidhje të personalizuar me teknologji të përparuar që përdoren nga më shumë se 150 klientë, të sektorit privat dhe atij shtetëror. Innovaway ka të punësuar 80 persona, ndërsa parashikon që ky numër të arrijë në 100 të punësuar në vazhdim.

AIDA ka asistuar investimin e Innovaway në Shqipëri që prej fillimit dhe nëpërmjet shërbimit Aftercare do të vazhdojë të mbështesë me asistencë çdo investitor të huaj, në çdo hap të rritjes së tij.



INNOVWAY	
INDUSTRIA:	ICT
KAPITALI:	100% ITALIAN
TË PUNËSUAR:	80
XHIRO (6M1 2019):	40 mln ALL

## SV Mega kompani me kapital italo-shqiptar që ka investuar në Shqipëri në fushën e automotivës



SV MEGA	
INDUSTRIA:	AUTOMOTIV
KAPITALI:	ITALO-SHQIPTAR
TË PUNËSUAR:	109
XHIRO (2019):	900,000 €
RIINVESTIMI:	1,100,000 €

SV Mega është një tjetër kompani me kapital italo-shqiptar që ka investuar në Shqipëri në fushën e automotivës. E themeluar në vitin 2014, sot kompania ka 109 të punësuar, dhe synon të rrisë më tej kapacitetet e saj prodhuese dhe aftësimin profesional të punonjësve. Kompania prodhon, përpunon, rifinon aksesore dhe komponentë të autoveturave dhe mjeteve të lundrimit.

Së fundimi, SV Mega ka përfituar nga shërbimet e AIDA-s dhe skema e kontratës së qirasë me “1 Euro” shërbimi, duke u zgjeruar përmes hapjes së një fabrikë të re, e cila është e specializuar në veshjen e timonëve në çelik dhe poliuretani.

## COTEX Textile, sipërmarrje me kapital turk që ka investuar në Shqipëri në fushën e tekstilit

E themeluar në vitin 2015 operon në Tiranë dhe Gjirokastrë dhe është e specializuar në industrinë e veshjes për marka të ndryshme gjermane, angleze dhe amerikane. Investitori synon të shtrijë aktivitetin e tij edhe në qytete të tjera të vendit. AIDA ka asistuar kompaninë me identifikimin e hapësirave për fabrikën e dytë. Asistenca e dhënë nga shërbimi After Care pranë AIDA-s ka ndikuar gjithashtu në rritjen e numrit të punonjësve nga 180 në vitin 2017, në 366 në vitin 2019.



cotex textile	
INDUSTRIA:	TEKSTILE
KAPITALI:	100% TURK
TË PUNËSUAR:	366
FABRIKA:	GJIROKASTËR, TIRANË
XHIRO:	481 MLN ALL (2019)

## TAKIME PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË MARDHËNIEVE ME INVESTITORËT E HUAJ TË ZHVILLUARA NË BASHKËPUNIM ME MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË



### **Ministrja e Financave dhe Ekonomisë Znj. Anila Denaj, viziton investimin gjerman “PSZ Albania”, në Vorë**

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë Znj. Anila Denaj, e shoqëruar dhe nga përfaqësues të AIDA-s, ka vizituar investimin gjerman “PSZ Albania”, në Vorë, që operon në fushën e manifakturës dhe është pjesë e grupit të suksesshëm Gjerman PSZ Electronic GMBH. Ministrja Denaj, gjatë vizitës shprehu angazhimin e qeverisë për të pëmirësuar klimën e biznesit dhe për të luftuar informalitetin në vend.

Kompania “PSZ Albania”, një investim gjerman në vendin tonë në sektorin e manifakturës, në sektorin e elektronikës dhe elektromekanikës, ka nisur aktivitetin e saj në Shqipëri prej 6 vitesh me 10 punonjës dhe sot ka të punësuar rreth 400 persona. Administratori i kompanisë bëri me dije se deri më tani kompania ka investuar rreth 1.5 milionë euro dhe parashikon të shtojë investimin e saj me rreth 800 mijë Euro në periudhën 2019-2020, si dhe të rrisë numrin e punonjësve deri në 700 persona në vitet e ardhshme.

Gjatë takimit u vlerësua edhe roli i Shërbimit After Care, sektor i dedikuar pranë AIDA-s për identifikimin e problematikave të investitorëve dhe adresimin e tyre në zgjidhjen përfundimtare në bashkëpunim me ministritë e linjës.





### **Ministrja e Financave dhe Ekonomisë Znj. Denaj viziton investuesit e Giobert**

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Znj. Anila Denaj, në takim të zhvilluar në kompaninë italiane Gioberti, vlerësoi punën e Agjencisë AIDA duke qenë e pranishme ndaj investitorëve të huaj edhe gjatë zhvillimit të planit të biznesit. AIDA i jep rëndësi të veçantë sektorit të industrisë automotivë në identifikimin e nevojave të tregut dhe krijimin e një oferte konkrete për tërheqjen e sa më shumë investitorëve në këtë fushë.

Kompania "Giobert Albania", operues prej gati një viti në tregun shqiptar, por me një histori të hershme në tregun italian që daton në vitin 1953, është e specializuar në industrinë mekanike në prodhimin dhe montimin e komponentëve metalikë dhe plastikë.

Gjatë takimeve nga sektori Aftercare i AIDA-s, kompania ka shprehur kënaqësinë mbi klimën e të bërit biznes në Shqipëri dhe efikasitetin e punonjësve. Kjo ka qenë dhe një arsye që kompania ka përzgjedhur Shqipërinë.


## TAKIME DYPALËSHE TË NIVELIT TË LARTË

AIDA ka si mision të rritjen dhe tërheqjen e investimeve të huaja në Shqipëri. Në funksion të këtij misioni, AIDA identifikon dhe promovon mundësitë e investimeve në vendin tonë, si dhe zhvillon veprimtari në funksion të përmirësimit të imazhit të Shqipërisë në nivel ndërkombëtar. Agjencia promovon Shqipërinë si një destinacion për investime, duke lehtësuar dhe mbështetur investimet direkte në Shqipëri. AIDA, nëpërmjet vizitave jashtë vendit, pjesëmarrjes në forume, takime ndërkombëtare, identifikon dhe promovon mundësitë për investime në vendin tonë.

### Vizita në Arabinë Saudite, një kapitull i ri bashkëpunimi mes dy vendeve

Kryeministri i Shqipërisë, Z. Edi Rama, ka zhvilluar në muajin Shkurt 2019, një vizitë zyrtare në Arabinë Saudite gjatë të cilës ka kryer një sërë takimesh të rëndësishme. Ai është pritur nga mbreti Salman ibn Abdulaziz Al Saudi, me të cilin u nënshkuan disa marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi duke çelur një kapitull të ri bashkëpunimi mes dy vendeve. Pjesë e këtij delegacioni ka qenë edhe Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, z. Sokol Nano, i cili ka theksuar në takimet e zhvilluara klimën e favorshme që Shqipëria ka për thithjen e investimeve të huaja, përfshirë edhe ato arabe.

Një takim shumë i rëndësishëm është vlerësuar ai me Ministrin e Financave, Mohammed bin Abdullah Al-Jadaan dhe Ministres tonë të Financave dhe Ekonomisë, Znj. Anila Denaj, ku shqyrtuan aspektet e bashkëpunimit financiar dhe ekonomik mes dy vendeve. Gjatë këtij takimi u arrit nënshkrimi i Marrëveshjes "Për eliminimin e taksimit të dyfishtë", çka nënkupton rritjen e bashkëpunimit mes dy vendeve në fusha të ndryshme të ekonomisë, si dhe rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe nxitjes së investimeve të huaja.



## Vizita zyrtare e Kryeministrit të Shqipërisë Z. Edi Rama në Pallatin Mbretëror në Monako

Kryeministri i Shqipërisë, Z. Edi Rama, zhvilloi një vizitë zyrtare në Principatën e Monakos, me ftesë të Princit Alberti II, në muajin Prill 2019. Kryeministri u prit në një ceremoni të veçantë zyrtare në Pallatin Mbretëror në Monako nga Princi Alberti II dhe kreu i qeverisë së Monakos Z. Serge Telle.

Në takimin e zhvilluar, Kryeministri Edi Rama dhe princi Alberti II vlerësuan bashkëpunimin e deritanishëm mes dy vendeve në fusha si ajo e mjedisit, turizmit, marinës, etj., dhe theksuan angazhimin e tyre për ta thelluar më tej këtë bashkëpunim në të ardhmen



Gjatë kësaj vizite zyrtare Kryeministri Z. Edi Rama, u shoqërua nga Z. Blendi Klosi, Ministër i Turizmit dhe Mjedisit, Z. Sokol Nano, Drejtori Ekzekutiv i AIDAs, Z. Etjen Xhafaj, Zv/ Ministër i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Ambasadori i RSH në Francë Z. Dritan Tola si dhe nga Presidenti i Dhomës së tregtisë Francë - Shqipëri Z. Julien Roche.

Në një moment të veçantë, Princi dekoroi Kryeministrin me medaljen e Komandantit të Urdhrit të Shën-Karlit të Principatës së Monakos, për merita të veçanta në forcimin e marrëdhënieve mes dy shteteve dhe angazhimin e tij në mbrojtjen dhe promovimin, si faktorë zhvillues për Mesdheun, të bregdetit dhe zonave detare. Urdhri i Shën Karlit është dekorata më e lartë e Principatës së Monakos, e themeluar nga paraardhësi i Albertit II, Princi Karl III, më 15 mars 1858.

## Shqipëria, pjesë e "EXPO2020 Dubai"

Shqipëria do të jetë pjesë e ngjarjes më të madhe "EXPO2020 Dubai", me nënshkrimin e kontratës nga Drejtori Ekzekutiv i AIDAs, Z. Sokol Nano, në rolin e Komisarit të Përgjithshëm për Shqipërinë EXPO2020.



EXPO2020 Dubai do të jetë një event ndërkombëtar i një standardi shumë të lartë dhe pjesëmarrja e Shqipërisë shënon një hap të rëndësishëm për prezantimin e potencialit të vendit tonë. Dubai do të shndërrohet për gjashtë muaj me radhë në shtëpinë e miliona vizitorëve dhe bizneseve nga e gjithë bota, të cilët do të vizitojnë ekspozitën botërore "Expo 2020 Dubai".

Shtetet pjesëmarrëse në EXPO 2020 Dubai që do të mbahet përgjatë periudhës 20 tetor 2020 - 10 prill 2021, do të kenë mundësinë të ekspozojnë arritjet e tyre në fusha të ndryshme. Pjesëmarrja e vendit tonë në një event të këtyre përmasave, do të shërbejë si një mundësi e rëndësishme për promovimin e Shqipërisë si një destinacion të veçantë dhe të qëndrueshëm turistik, duke shpalosur bukuritë e vendit tonë, kulturën dhe traditën e pasur shqiptare.

Një nga objektivat kryesorë do të jetë padyshim promovimi i Shqipërisë si një partner i besuar tregtar dhe i investimeve të huaja në një sërë sektorësh të rëndësishëm për vendin si energjia, turizmi, infrastruktura, bujqësia, etj.

AIDA, së bashku me Ministrinë e linjës po përgatishin kalendarin me një sërë aktivitete dhe takime mbi ekonominë, investimet, turizmin, kulturën, arsimin, artin, kulinarinë etj., të cilat do të mbahen gjatë kohëzgjatjes gjashtë mujore të EXPO-s, duke i dhënë gjithashtu një peshë të rëndësishme edhe të rinjve shqiptarë dhe talenteve tona nëpër botë.



## Investitorë potencial nga Arabia Saudite, tur vizitash në Shqipëri

Me ftesë të veçantë nga Kryeministri i vendit Z. Edi Rama, 25 investitorë nga Arabia Saudite erdhën në Shqipëri për një "Business Tour" tre ditor gjatë muajit Prill 2019. Delegacioni i drejtuar nga Zv/Kryetari i Unionit të Dhomave të Tregtisë Z. Muneer M. Bin Saad, ka zhvilluar takime me Drejtorin Ekzekutiv të AIDA-s Z. Sokol Nano dhe përfaqësues të tjerë, të cilët i kanë shoqëruar gjatë gjithë turit të biznesit.

Z. Muneer M. Bin Saad zhvilloi dhe një takim me Z. Gent Cakaj, Ministër i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, si dhe vizituan kompanitë PSZ Albania dhe atë të bimëve medicinale dhe vajrave aromatike - Alb Kalustyan. Gjithashtu, gjatë ditëve të turit u nënshkrua dhe një MoU mes Unionit të dhomave të Tregëtisë së Shqipërisë dhe asaj të Arabisë Saudite.



## Delegacioni Rumun i Biznesit zhvillon një vizitë në vendin tonë, me synim investimin

Biznesmenë rumun vizituan Shqipërinë në maj 2019 dhe patën mundësinë të zhvillonin takime pune me përfaqësues të dhomave të tregëtisë dhe autoritete shtetërore.

Në kuadër të kësaj vizite, delegacioni rumun zhvilloi një takim pranë zyrave të AIDA. Në këtë takim u diskutua mbi panoramën e përgjithshme të investimeve në Shqipëri, ku u dhanë informacione mbi infrastrukturën e vendit, regjimin e taksave, kualifikimin e forcës punëtore dhe lehtësirat fiskale dhe ekonomike që parashikohen për investitorët e huaj.

Gjithashtu, delegacioni u prezantua me mundësi konkrete investimi në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke theksuar rolin e AIDAS, si institucion lehtësues dhe mbështetës në realizimin e këtyre investimeve.



## Kompani gjermane vizitojnë Shqipërinë me synim investimin

AIDA organizoi aktivitetin “Automotive Week” në muajin Maj 2019, për promovimin e Shqipërisë si një destinacion investimesh në sektorin Automotiv.



Në këtë kuadër, pesë kompani gjermane të këtij sektori vizituan vendin tonë dhe patën mundësinë të zhvillonin takime dhe vizita në kompani që operojnë në sektorin automotiv, për të kuptuar më tepër mbi mundësitë konkrete që ofron vendi ynë. Kompanitë gjermane u pritën në një vizitë edhe nga përfaqësuesit e AIDA-s, ku u njohën me mundësitë e investimeve, duke u vënë theksi tek incentivat që qeveria ofron për këtë sektor.

Takimet vijuan edhe me përfaqësues të lartë shtetërorë, të cilët prezantuan institucionin dhe mundësitë që ofron Qeveria Shqiptare për vënien në zbatim të projekteve të investimeve.

Për të marrë një impakt më të qartë, grupi Gjerman vizitoi dy kompani tepër të suksesshme në këtë sektor, të cilat prej vitesh tashmë operojnë në vëndin tonë si: kompania Gjermane "Forschner Albania" dhe kompaninë italiane "Rework" treguan historinë e tyre të suksesit në Shqipëri dhe avantazhet e të bërit biznes në vendin tonë.

Ndalesa e fundit ishte "TEDA Spitalë", ku investitorët u njohën me TEDA dhe mundësitë që ata kanë për investime në këto zona.

Në përfundim të kësaj vizite, delegacioni vlerësoi me interes të lartë investimet në vendin tonë dhe u shprehën tejet optimist për të ardhmen e kësaj industrie nisur nga pozita gjeografike, kostot konkurruese të punës, fuqia punëtore e kualifikuar dhe masat mbështetëse nga qeveria.




## Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Sokol Nano, takon Ambasadorin e Republikës së Bullgarisë, Z. Momtchil Raytchevski

Drejtori i AIDA-s, Z. Sokol Nano, priti në një takim Ambasadorin e Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Bullgarisë, në Republikën e Shqipërisë, Z. Momtchil Raytchevski dhe Znj. Maria Peeva, atashë në Ambasadën e Bullgarisë.

Gjatë takimit palët diskutuan rreth fushës së veprimit të AIDA-s, si dhe asistencës që ajo ofron jo vetëm ndaj investitorëve strategjikë, por dhe në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Një pjesë e rëndësishme e bisedës u fokusua rreth zhvillimit të bashkëpunimeve mes drejtuesve të organizatave të promovimit të investimeve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, më së shumti në fushën e IT dhe Teknologji, por edhe në shërbimin Call Center dhe Data Center, kuadër në të cilin do të mbahet edhe një organizim në Janar të vitit 2020. Përmes këtij event synohet thellimi më tej i procesit të shkëmbimit të njohurive dhe përvojave, si dhe zhvillimin e lidhjeve për krijimin e kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet kompanive në fushën e inovacionit dhe start-up.

Takimi i mbajtur, i hap rrugën krijimit të raporteve më të ngushta për bashkëpunim mes Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve dhe Agjencive simotra, apo me fokus të njëjtë në shtetin bullgar.





## Jepja besën bujkut

AIDA ju fton të pasuroni tryezat tuaja me ushqime të prodhura nga fermerët vendas. Blini nga bujqit shqiptarë, zgjidhni produktet vendase, për të konsumuar shëndetshëm, përkrahur bujqësinë, ekonominë e fermerëve lokalë dhe si rrjedhojë zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

**Jepja besën bujkut!**





invest in Albania

## Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

### Çfarë ofrojmë:

- Promovimi i produkteve dhe shërbimeve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.
- Promovimi i Shqipërisë si destinacion për investimet e huaja.
- Facilitimi dhe mbështetja e investimeve të huaja direkte në Shqipëri.
- Informacion i kualifikuar mbi incentivat, politikat dhe skemat e qeverisë.
- One-Stop-Shop për investitorët strategjikë.
- Ndërmjetësimi mes bizneseve dhe organeve të tjera qeveritare.
- Ndihmë dhe mbështetje mbi përgatitjen e planeve të biznesit për investitorët e huaj.
- Mbështetja e investimeve nëpërmjet sektorit After Care.

Adresa: Blv. "Deshmoret e Kombit" Kryeministria, Kati III,  
Tiranë

Tel : +355 042 251001

Email: [info@aida.gov.al](mailto:info@aida.gov.al) | Web: [www.aida.gov.al](http://www.aida.gov.al)